



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror
Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 18.02.2015, në orën 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku dhe Melihate Tërmkolli.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Milena Miliqeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Mark Hough – Erol, Romana Macesic, Bekim Maloku, Zordan Sirakov, Naim Hajdari – EULEX, Behxhet SH. Shala- KMDLNj, Ukë Gashi – ZPRK, Adem Gashi dhe Bryan Marcus – US. Embassy, Valdet Hajdini – IKD, Dardan Berisha D4D, Naim Jakaj – V.V, Ardian Bajrakari – MD, Fitore Hajdini dhe Floriana Merovci – ZPRK.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi dhe Hana Bajraktari.

Mbledhjen e kryesoi Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.1.2015;
3. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
4. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr. 05/L-03 për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht;

5. Formimi i grupit punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik;
6. Shqyrtimi i kërkesës së Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës;
7. Shqyrtimi i propozimit të Fakultetit Juridik për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës;
8. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi që në pikën të ndryshme të diskutohet edhe formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si dhe një njoftim për vizitën në QK Dubravë.

Kryetarja konstatoi se rendi ditës miratohet me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.1.2015

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 19.1.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryetarja - Tha se në mbledhjen e fundit dhe në katër mbledhjet e kaluara kemi diskutuar për funksionalizimin e Këshillit Gjyqësor. Pra, në mbledhjen e fundit propozova që të shkohet me konkurs, por dominoi ideja që të kërkohet nga Këshilli Gjyqësor që t'i sjellë emrat e të gjithë gjyqtarëve të Republikës së Kosovës dhe siç edhe e keni parë Këshilli ka sjellë 285 emra të gjyqtarëve, ku siç thuhet në shkresën përcjellëse që në këtë listë nuk janë përfshirë gjyqtarët të cilët janë në procedurë disiplinore, apo ju ka shqiptuar ndonjë masë nga Komisioni disiplinor. Po ashtu në këtë shkresë thuhet se nuk kemi informata se ndonjërit nga emrat e propozuar është hapur hetim penal. Emrat e propozuar vijnë nga Gjykata Supreme e Kosovës, duke përfshirë edhe kandidatët nga Dhoma e Veçantë; Gjykata Themelore dhe e Apelit në Prishtinë, me degët në Podujevë, Lipjan, Gllogoc dhe Graçanicë; Gjykata Themelore në Ferizaj, me degët në Shtërpçë dhe Kaçanik; Gjykata Themelore në Gjilan, me degët në Viti, Kamenicë dhe Novobërdë, Gjykata Themelore në Pejë, me degët në Istog, Deçan dhe Klinë; Gjykata Themelore në Gjakovë, me degët në Rahovec dhe Malishevë; Gjykata Themelore në Prizren, me degët në Suharekë dhe Dragash, si dhe Gjykata në Mitrovicë, me degët në Skenderaj, Vushtrri dhe Leposaviq. Andaj, është shumë e rëndësishme që ta gjejmë një mënyrë se si t'i shqyrtojmë të gjithë këta emra që tani i kemi para vetes.

Selvije Halimi - Tha se tani e sa kohë Këshilli Gjyqësor është jo funksional dhe si pasojë e kësaj edhe vendimmarrja është e pa mundur që të bëhet procesimin për zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj që sipas informacioneve janë diku 40 kandidatë që duhet të zgjedhën. Meqenëse kemi pasur një grup gjyqtarësh që më herët na janë sjellë nga Këshilli, si dhe tani propozimet shtesë me emrat që tani i kemi para vetes dhe kemi pasur kohë të mjaftueshme që t'i shikojmë. Ajo vlerësoi se është koha që të shikojmë me propozime konkrete pasi kemi diskutuar mjaft dhe është koha të vendosim dhe të procedojmë për Kuvend. Pasi kam fjalën propozoj që për anëtarë të KGJK-së të emërohet Armend Berisha nga Gjykata Themelore në Pejë, si dhe Nehat Idrizi, Gjykata Themelore në Prishtinë. Nëse jeni dakord ne mund të procedojmë me këta emra, nëse jo atëherë është mirë të arsyetoni pse nuk mund të procedohen.

Albulena Haxhiu- Duke u ndërlidhur me parafolësen tha se as me kushtetutë dhe as me Ligjin për këshillin gjyqësor nuk është përcaktuar mënyra e votimit në Kuvend. Sipas praktikës, nëse ka vetëm një kandidat, për një pozitë, votimi në Kuvend ka shkuar në pako, siç e kishim rastin e fundit me anëtarët e IGJK-së, ku personalisht isha kundër, pasi ata as profesionalisht nuk janë të njëjtë. Nëse kemi dy propozime apo më shumë shkohet me votim të fshehtë dhe për këtë vendos Komisioni pasi nuk kemi të specifikuar ndonjë procedurë se si të votohen. Keni parasysh që po flasim për 5 pozita të lira, 3 shqiptarë, 1 nga minoriteti serb dhe 1 nga komunitetet e tjera. Njëri nga 3 pozitat që vijnë nga radhët e shqiptarëve duhet të jetë gjyqtar, njëri avokat dhe një tjetër, që sipas ligjit që duhet të ketë përvojë pune 10 vjet në çfarëdo fushe. Ishte e mendimit që duhet të filtrohet kjo listë duke përcaktuar kriteret të përgjithshme p.sh. 3-4 vjet në gjyqësor ose të shikohet se cili ka qenë raporti i tij me Këshillin Gjyqësor, vlerësimin për punën si gjyqtarë, reputacion të lartë etik, përfaqësimi gjeografik dhe gjinor, pra këto do të mund të ishin disa kriteret dhe të mblidhemi të hënën dhe t'i shqyrtojmë CV-të një nga një sepse është jo serioze që të procedojmë në këtë mënyrë pasi kemi kërkuar gjithë këta emra. Ajo në vazhdim foli edhe për propozimin e odës së avokatëve e cila mbetet parapa qëndrimit që Oda e ka sjellë propozimin e saj dhe nuk ka vepruar sipas kërkesës së Komisionit që t'i sjellë edhe dy emra shtesë. Ajo kërkoi nga Selvije Halimi t'i arsyetoj propozimet për kandidatet e propozuar.

Selvije Halimi - Tha se propozimi për kandidatet mbështetet në CV-të e tyre, e që përmban edhe një përfshirje gjeografike dhe asaj që kemi diskutuar tash e sa mbledhje dhe nuk kamë çka të shtojë më shumë sesa ajo që përfshihet në CV-të e tyre. Ajo tha se jam për atë që kemi nevojë t'i ndryshojmë këto ligje për të përcaktuar kriteret të çarta. Tutje shtoi se arsyeja pse duhet të procedojmë shpejt për ta plotësuar këtë institucion është sepse jemi vonë e që kjo po ndikon në mos përmbushjen e obligimeve të tjera që ka ky institucion. Kurse lidhur me atë se cili është raporti i këtyre emrave që propozova me Këshillin, ne vetëm mund të supozojmë, kurse rreth reputacionit të kandidatëve edhe kjo është çështje e perceptimit individual. Ajo shtoi se nuk duhet të nisemi nga supozimi se puna në këshill nuk ka shkuar mirë dhe të fiksohemi që të emërojmë njerëz. Kjo për faktin se është përgjegjësi kur propozon emra, a janë kredibil dhe a do të ndihem keq se i kam përmendur emrin që ky emër të votohet në Kuvend. Në fund tha se kur marrë

guximin që të propozoj emra për një organ të tillë, që është kaq i ndjeshëm, pra sfera gjyqësorit, unë i jap vetes një obligim dhe përgjegjësi që në momentin kur kam informacione të bazuara se këta njerëz po e atakojnë kriterin profesional dhe moral, unë do të jem e zëshmjja e parë karshi këtyre çështjeve. Andaj, propozoi që sot të procedohet me emra për Kuvend sepse mjaft jemi vonuar.

Armend Zemaj – Tha se ajo çka ne duhet të bëjmë sot është t'i dërgojmë propozimet dhe ta bëjmë Këshillin funksional duke përmbushur kështu obligim Kushtetues dhe ligjor. Nuk është hera parë që propozojmë kandidatët për anëtarë dhe deri sa të kemi ndryshime kushtetuese dhe ligjore ne duhet të shkojmë në këtë formë. Andaj ne nuk mund që Kuvendin ta qesim në lajthitje se çfarë mënyra të votimit do të ketë në Kuvend. Jemi komision i ligjeve i caktojmë emrat dhe i procedojmë në Kuvend, dhe Kuvendi pastaj vendos. E përkrahu propozimin e Selvije Halimit që të shkohet me propozime konkrete ndoshta e marrim edhe propozimin nga deputeti Danush Ademi që i përket komunitetit tjetër, siç përcaktohet me Kushtetutë, kurse për komunitetin serb sot nuk është prezent, ndoshta këtë mund ta shikoj edhe kryetarja se si të procedojmë. Për ndryshe nëse nuk kemi propozime të tjera shkojmë me këto që i propozoj Selvija. Kurse rreth propozimit të Odës ne edhe mund të procedojmë me kandidatin e propozuar edhe pse mendoj që është dashur të sjellin edhe emra të tjerë. Në fund tha se, si Komision, do të duhej të marrim iniciativën për ndryshimin e ligjit për këshillin gjyqësor dhe ligjit prokurorial në mënyrë që mos të kemi këso dilema.

Kryetarja edhe njëherë kërkoi nga anëtarët se nuk duhet të procedohet me kaq urgjencë dhe propozoi që fillimisht të përcaktohen kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, të përcaktohet mënyra e votimit në Kuvend, pra mos të shkohet me votim në pako, dhe në fund, të shkohet me propozimet për anëtarë, konform nenit 108, paragrafi 6, pika 2 dhe 4 e Kushtetutës.

Doruntinë Maloku- Foli lidhur me propozimin Odës së Avokatëve e cila nuk ka sjellë emra të tjerë dhe ishte e mendimit që edhe njëherë të kërkohet nga Oda që të kemi edhe dy propozime të tjera ose t'i kemi edhe nënshkrimet e anëtarëve të Odës që e mbështetin vetëm kandidatin e propozuar sepse kjo është arbitrare.

Danush Ademi- Propozoi që nga radhët e Komuniteteve, siç përcaktohet me Kushtetutë, gjegjësisht nenin 108, paragrafi 6, pika 4 e Kushtetutës, të jetë anëtarë z. Gjimeshi Galjushi, nga Gjykata Themelore në Prizren i cili ka një përvojë të gjatë si gjyqtar dhe i përket nacionalitetit Romë.

Melihate Tërmmkollli- U pajtua që të kemi edhe emra të tjerë nga Oda Avokatëve, sepse ata nuk mund të sillen në mënyrë diktati, ashtu siç po veprojnë tani.

Nezir Çoçaj- E ndau mendimin se nuk do të duhej që t'i bëhet presion Odës së Avokatëve që të sjellë emra të tjerë, sepse vlerësoj se avokatet janë takuar edhe kanë vendosur që të propozojnë emrin që tani e kemi para vetes.

Agim Aliu- Tha se, si Komision, i kemi kushtuar një kohë të gjatë kësaj çështje dhe tani kemi ardhur në një fazë që duhet të sigurohemi se jemi duke vendosur në mënyrën më të mirë. Po ashtu kemi ardhur me një fazë ku ne duhet të vendosim qoftë në bazë të rrethanave të krijuara në Këshillin Gjyqësor dhe në përgjithësi në sistemin e Drejtësisë si derivim i mos funksionimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Për deri sa kemi ardhur në këtë fazë vlerësoi se duhet të tejkalohet siç edhe e kam thënë edhe në mbledhjet e kaluara, si është e mundur që tash e 15 vjet nuk kemi procedura të qarta të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor? Ai ishte i mendimit që duhet të funksionalizohet Këshilli dhe pastaj të shikohet mundësia e ndryshimit të ligjit duke vendosur procedura të qarta për zgjedhjen e këtyre anëtarëve në mënyrë që mos të na përsëriten këso situata.

Agim Ademaj- Tha se cila do të jetë e drejta jonë ligjore që edhe njëherë të kërkojmë nga Oda Avokatëve që të sjellë emra të tjerë për derisa kemi edhe një përgjigje shtesë nga Oda që mbeten pranë propozimit të dërguar më herët. Për këtë kërkoi kujdes që kjo çështje në raport me odën mos të merret si imponim.

Kryetarja -Në fjalën e saj të serishme kërkoi që mos të shkohet në votim në pako, por ta përcaktojmë mënyrën e votimit në Kuvend, si dhe është jo e drejtë që mos t'i shqyrtojmë CV-të që i kemi kërkuar për të gjithë gjyqtarët. Ajo tha se me çfarë kriteri vendoset që këta kandidat janë më të mirë në mesin e 285 kandidatëve të tjerë.

Selvije Halimi- Ajo kërkoi nga kryetarja e Komisionit që propozimet për dy anëtarët, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, pika 2 e Kushtetutës, dhe propozimin nga radhët e komunitetit tjetër, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, pika 4 e Kushtetutës, që e bëri deputeti Danush Ademi t'i qesë në votim.

Kryetarja hodhi në votim propozimin e Selvije Halimit dhe Danush Ademit që të votohen në pako kandidatët për anëtarë të Këshillit Gjyqësor, ku me 7 vota “për” dhe 1 votë “kundër”, Komisioni vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të emërohen anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kandidatët:

1. Nehat Idrizi, Gjykata Themelore në Prishtinë,
2. Armend Berisha, Gjykata Themelore në Pejë, dhe
3. Gjimeshit Galjushi, Gjykata Themelore në Prizren.

4. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr. 05/L-03 për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht

Komisioni formoi Grupin punës për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-03 për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht në përbërje:

- Armend Zemaj - kryesues,
- Selviqe Halimi - anëtare, dhe
- Danush Ademi – anëtar.

5. Formimi i grupit punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik

Komisioni formoi Grupin punës për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik, në përbërje:

- Albulena Haxhiu - kryesues,
- Agim Aliu - anëtar, dhe
- Agim Ademaj – anëtar.

6. Shqyrtimi i kërkesës së Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/39, për shpalljen e Kompleksit Përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz, me interes të veçantë nacional dhe vendosi që kërkesa t’i procedohet Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, si Komision Funksional për trajtimin e kësaj çështjeje.

7. Shqyrtimi i propozimit të Fakultetit Juridik për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Komisioni e shqyrtoi propozimin e Fakultetit Juridik, për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe vlerësoi se propozimi për emërimin e anëtarit është

në përputhje me nenin 3.3 të Ligjit nr. 02/L-25 për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, dhe vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, kandidati:

Rexhep Gashi- anëtar nga Fakulteti Juridik.

8. Të ndryshme.

Kryetarja i njoftoi anëtarët se më 20.2.2015 do të realizohet vizita e Komisionit në QK Dubravë dhe i ftoi që të jenë pjesë e vizitës pasi është edhe një aktivitet që del nga plani punës së Komisionit, si dhe tani më kemi një kërkesë nga të burgosurit me 120 nënshkrime.

Komisioni diskutoj për formimin e grupit punës për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe vendosën që kryesues të caktohet një anëtar nga grupi parlamentar i AAK-së, pasi që deputetja Melihate Tërmkolli ka kaluar në grupin parlamentar të LDK- së.

Komisioni formoj grupin punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në përbërje:

- GP AAK - kryesues,
- Albulena Haxhiu - anëtare,
- Nezir Çoçaj – anëtar,
- Doruntinë Maloku – anëtare, dhe
- Agim Ademaj – anëtar.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Albulena Haxhiu